

**VENDIM**  
**Nr. 518, datë 25.9.2025**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË**  
**MINISTRISË SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i Ministrisë së Mbrojtjes është hartimi, zbatimi dhe mbikëqyrja e politikave të mbrojtjes kombëtare duke siguruar pavarësinë e vendit, si dhe mbrojtja e tërësisë territoriale dhe rendit kushtetues.

3. Në fushën e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes përfshihen:

- a) mbrojtja dhe siguria kombëtare;
- b) zhvillimi strategjik i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;
- c) arsimi ushtarak;
- ç) mjekësia ushtarake;
- d) industria ushtarake;
- dh) inovacioni në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;
- e) emergjencat civile;
- ë) rezervat materiale të shtetit;
- f) çdo fushë tjetër që i përcaktohet me ligj apo akt nënligjor.

4. Ministria e Mbrojtjes për realizimin e fushës së përgjegjësisë, sipas pikës 3, të këtij vendimi, është përgjegjëse, për:

- a) hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;
- b) zhvillimin e kapaciteteve operacionale, njerëzore dhe infrastrukturore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet modernizimit të tyre të vazhdueshëm;
- c) hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të industrisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë;
- ç) miradministrimin dhe zhvillimin e pronave të paluajtshme të mbrojtjes, me qëllim maksimizimin e funksionalitetit në shërbim të Forcave të Armatosura, si dhe rritjes së eficiencës së tyre ekonomike;
- d) përfaqësimin dhe pjesëmarrjen në organizatat ndërkombëtare të mbrojtjes e të sigurisë dhe bashkëpunimit me NATO-n;
- dh) hartimin e politikave dhe strategjive në fushën e mbrojtjes civile;
- e) hartimin dhe mbikëqyrjen e politikave për krijimin dhe menaxhimin e rezervave ushtarake e të rezervave materiale të shtetit;
- ë) nxitjen e inovacionit dhe të proceseve të lidhura me teknologjinë dhe projektet që i përkasin fushës së mbrojtjes dhe sigurisë, dhe kontrollit të territorit.

5. Vendimi nr. 605, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes”, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**